



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2021:078190  
Datë: 15.05.2024  
Numri i dokumentit: 05689331

**Ac.nr.7197/22**

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË**, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Arsim Hamzaj - kryetar i kolegjit, Burim Shala e Naime Ahmeti - anëtarë të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të paditëses A.P, nga Gj,,,, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson F.S, avokat në Gj,,,, kundër të paditurës Qendra Kombëtare e Mjekësisë së Punës në Gjakovë, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson B.R.B, me objekt kontesti pagesën e shpërblimit jubilar, vlera e kontestit ,,€, duke vendosur sipas ankesës së të paditurës, të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Gjakovë - departamenti i përgjithshëm, C.nr.535/2021, të datës 19.08.2022, në seancën e kolegjit, të mbajtur me datën **15.05.2024**, mori këtë:

**A K T G J Y K I M**

**I.REFUZOHET e pathemeltë** ankesa e paditurës Qendra Kombëtare e Mjekësisë së Punës në Gjakovë, ndërsa pika **I (një)** dhe **II (dy)** e dispozitivit të aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Gjakovë - departamenti i përgjithshëm, C.nr.535/2021, i datës 19.08.2022, **VËRTETOHEN**.

**II.** Në pikën **III (tre)** të dispozitivit aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Gjakovë - departamenti i përgjithshëm, C.nr.535/2021, i datës 19.08.2022, **mbetet i pashqyrtuar**.

**A r s y e t i m**

Gjykata e shkallës së parë, me aktgjykimin e atakuar, C.nr.535/2021, të datës 19.08.2022, në pikën **I (një)** të dispozitivit, e ka aprovuar në pjesërisht të bazuar kërkesëpadinë e paditëses A.P, nga Gj,,,. Në pikën **II (dy)** të dispozitivit, e ka detyruar të paditurën Qendra Kombëtare e Mjekësisë së Punës, me seli në Gjakovë, që paditëses A.P, nga Gj,,,, në emër të shpërblimit jubilar t'ia paguaj vlerën e tri pagave bazë shumë prej 1,695.00 me kamatë ligjore prej 8%, e cila do të llogaritet nga data e paraqitjes së padisë, datë 21.04.2021, deri në pagesën definitive,

si dhe shpenzimet e procedurës kontestimore në shumë të prej 269,00€, (dyqind e gjashtëdhjetë e nëntë) në afat prej 7 ditësh nga pranimi i këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit të detyrueshëm. Në pikën *III (tre)* të dispozitivit e ka refuzuar të pabazuar pjesën tjetër të kërkesëpadisë së paditëses mbi shumat e gjykuara, dhe atë që në emër të shpërblimit jubilar t'ia paguaj vlerën e tri pagave bazë në lartësi prej 80.85€, si e pabazuar.

Kundër këtij aktgjykimi e paditura në afat ligjor ka paraqitur ankesë, duke e atakuar të njëjtin për shkak të *vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike*, me propozim që Gjykata e Apelit aktgjykimin e atakuar ta hedhë poshtë dhe ta aprovoj si të bazuar ankesën e të paditurës.

Paditësja, përmes të autorizuarit të saj, ka parashtruar përgjigje në ankesën e të paditurës.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar, në mbështetje të dispozitës të nenit 194 dhe 195, të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

*- Ankesa e të paditurës është e pathemeltë.*

Nga shkresat e lëndës rrjedh se paditësja, përmes të autorizuarit të saj, me datën 21.04.2021, në gjykatën e shkallës së parë ka paraqitur padi kundër të paditurës, për kompensimin e pagave për shpërblimin jubilar, me arsyet si në padi.

Gjykata e shkallës së parë duke vepruar sipas padisë, pas shqyrtimit dhe administrimit të provave të propozuara nga palët ndërgjyqëse, ka nxjerrë aktgjykimin e atakuar C.nr.535/2021, të datës 19.08.2022, me të cilin pjesërisht e ka aprovuar kërkesëpadinë e paditëses, duke vendosur më decidivisht si në dispozitiv të aktgjykitimit të atakuar.

Në arsyetimin e aktgjykitimit të atakuar, gjykata e shkallës së parë ka theksuar se nga kontrata e punës me Nr.188/4 e datës 02 maj 2014, gjykata vërtetoi faktin se paditësja A.P është në marrëdhënie pune tek e paditura, respektivisht në QKMP në Gjakovë, me detyrat e punës si Zyrtare Shpenzuese, në kohë të pacaktuar. Nga lista e pagave e lëshuar nga Buxheti i Republikës së Kosovës i datës 30 mars 2021, gjykata vërtetoi faktin se paditësja A.P realizon të hyra nga paga bazë në vlerë prej 565.00 € e përcaktuar sipas listës së pagave e me numër BL7721 Buxheti i Republikës së Kosovës, ndërsa nga Vendimi i lëshuar nga SHSKUK-Qendra Kombëtare e Mjekësisë së Punës e datë 08 mars 2022, Gjykata vërtetoi faktin se paditësja A.P është e punësuar pranë të paditurës në vendin e punës Zyrtare Shpenzuese dhe e njëjta ka 33 (tridhjetë e tre) vite përvojë pune. Lidhur me bazën ligjore gjykata e shkallës së parë është mbështetur në dispozitat e nenit 17 par. 3 pika 3.3 të Kontratës Kolektive Sektoriale të Shëndetësisë, në të cilën është e paraparë e drejta e pagesës për pagat. Lidhur me kumatën ka vendosur në bazë të nenit 382 të LMD-së, ndërsa lidhur me shpenzimet e procedurës ka vendosur në bazë të nenit 449 dhe 452 të LPK-së.

Gjykata e Apelit e aprovon në tërësi vlerësimin juridik të gjykatës së shkallës së parë si të rregullt dhe të ligjshëm sa i përket vendosjes si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar, për arsye se i njëjti nuk është përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore të pretenduara, dhe as në shkeljet nga neni 182 parag.2, pika b), g), j), k) dhe m), të LPK-së, dhe rrjedhimisht nuk ka aplikim të gabuar të së drejtës materiale për të cilat gjykata kujdeset sipas detyrës zyrtare sipas nenit 194 të LPK-së.

Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, dispozitivi i aktgjykimit të atakuar është mjaftë i qartë, e në përputhje të plotë me arsyet e aktgjykimit, duke qenë kështu në harmoni logjike dhe juridike dispozitivi me arsyetimin. Gjykata ka arsyetuar të gjitha faktet vendimtare për themelësinë e kërkesëpadisë e në lidhshmëri me këtë ka arsyetuar mënyrën se si janë vërtetuar faktet dhe mënyrën se si i ka vlerësuar provat për secilin fakt të provuar.

Poashtu gjendja faktike është vërtetuar në mënyrë të drejtë dhe disa fakte vendimtare nuk kanë qenë kontestuese. Nga provat që ka administruar gjykata e shkallës së parë është vërtetuar se paditësja është i punësuar tek e paditura në QKMP në Gjakovë që nga 01.03.1991.

Nuk qëndrojnë pretendimet ankimore se gjykata e shkallës së parë gabimisht ka aplikuar të drejtën materiale, kjo për arsyeje se me nenin 90 paragraf 1 të Ligjit të Punës 03/L-212 të datës 01.11.2010, përcaktohet se “Marrëveshja Kolektive mund të lidhet në mes: a) organizatës së punëdhënësve ose përfaqësuesit të tij, dhe b) organizatës së të punësuarve ose kur nuk ekzistojnë organizata, marrëveshjen mund ta lidhin edhe përfaqësuesit e të punësuarve. Me paragrafin 1 të këtij neni përcaktohet se Marrëveshja Kolektive mund të lidhet a) të nivel të vendit, b) në nivel të degës dhe c) nivel të ndërmarrjes. Me paragrafin 3 të këtij neni përcaktohet se Marrëveshja Kolektive duhet të jetë në formë të shkruar, në gjuhën zyrtare të Republikës së Kosovës. Me paragrafin 4 përcaktohet se Marrëveshja Kolektive vlen për ata punëdhënës dhe punëmarrës të cilët marrin përsipër detyrimet e përcaktuara me marrëveshjen e tillë kolektive”.

Me nenin 17 paragraf 3, të Kontratës Kolektive Sektoriale, e cila ka hyrë në fuqi me datën 11.06.2018, përcaktohet se “Punëtorët shëndetësor, në vitet jubilarë të punësimit përfitojnë shpërblimin jubilar nga punëdhënësi i fundit në vlerë: 3.1. Për 10 vjet të përvojës në punë në institucione shëndetësore, në vlerë të një page mujore të tij; 3.2. Për 20 vjet të përvojës në punë në institucione shëndetësore, në vlerë të dy paga mujore të tij; 3.3. Për 30 vjet të përvojës në punë në institucione shëndetësore, te punëdhënësi i fundit në vlerë të tri paga mujore të tij”. Me nenin 17 parag.4 të kësaj Marrëveshje përcaktohet se: “Punëdhënësi i fundit është ai që paguan shpërblime jubilarë. Shpërblimi jubilar, paguhet në afat prej një muaji, pas plotësimit të kushteve nga ky paragraf”. Andaj mbi bazën e të lartcekurave, kjo gjykatë gjeti se gjykata e shkallës së parë drejtë ka vendosur kur e ka aprovuar kërkesëpadinë e paditëses si të bazuar, për çka edhe vendosi që të njëjtin ta vërtetoj sikurse në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

Nga arsyet e lartcekura, Gjykata e Apelit e aprovon në tërësi arsyetimin e aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë sa i përket vendosjes lidhur me aprovimin e kërkesëpadisë së paditëses që në emër të shpërblimit jubilar t’ia kompensojë shumën e aprovuar si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar. Gjithashtu edhe për lartësinë e kërkesëpadisë gjykata e shkallës së parë

ka vendosur drejtë dhe në mënyrë të ligjshme, pasi që në shkresat e lëndës ka pasur prova të mjaftueshme, nga të cilat edhe është vërtetuar saktësisht lartësia e kërkesëpadisë dhe vërtetimi për përvojën e punës sipas të cilit paditësja vitin jubilar e ka arritur në vitin 2021, në kohën kur ka qenë në fuqi Kontrata Kolektive Sektoriale e Shëndetësisë e cila e ka paraparë shpërblimin jubilar si beneficion për përvojën e punës, andaj dhe u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Në këtë drejtim edhe vendimi për shpenzimet e procedurës është në përputhje me dispozita e LPK-së, dhe sa i përket lartësisë është në harmoni me tarifën e Odes së Avokatëve dhe tarifatat për shpenzime gjyqësore.

E drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë edhe sa i përket kërkesës aksesore përkitazi me kamatën.

Gjykata e Apelit vendosi si në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi, pasi që ka rezultuar se nuk ka pasur pretendime ankimore nga pala paditëse ndërsa vendimi në këtë pjesë është në favor të paditurës, andaj edhe kjo pjesë e dispozitivit të aktgjykimit të atakuar ka mbetur të pashqyrtuar.

Gjykata e Apelit me rastin e vendosjes i vlerësoi edhe të gjitha pretendimet e tjera ankimore, mirëpo të njëjtat nuk ishin me ndikim për një vendim ndryshe për çka edhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Nga arsyet e cekura Gjykata e Apelit, gjeti se gjykata e shkallës së parë në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme ka vendosur në këtë çështje juridike, prandaj në mbështetje të dispozitave nga neni 194, 195 par. 1 pika d) të LPK-së, lidhur me neni 200 të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË**  
**Ac.nr.7197/22, datë 15.05.2024**

**Kryetari i kolegjit - gjyqtari**  
**Arsim Hamzaj**